

VENDIM
Nr. 222, datë 28.3.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE PËR ETIKETIMIN E MATERIALEVE QË PËRDOREN NË PËRBËRËSIT KRYESORË TË VESHJEVE TË KËMBËS, NË SHITJE PËR KONSUMATORËT”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Mbi tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullave teknike për etiketimin e materialeve që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, në shitje për konsumatorët, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

¹ Ky projektvendim përfron direktivën nr. 94/11/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit, të 23 marsit 1994, mbi përfrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare në lidhje me etiketimin e materialeve të përdorura në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, në shitje për konsumatorët.